



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INTEGRIMIT

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit



Gjatë vitit 2008 Ministria e Integrimit do të vazhdojë të udhëheqë progresin e Shqipërisë drejt Bashkimit Evropian. Një nga objektivat kryesore dhe ambicioze të këtij viti është fillimi i procedurave për marrjen e statusit të vendit kandidat nga ana Shqiperisë. Në këtë kontekst, Ministria e Integrimit do të vazhdojë të punojë me intesivitet për koordinimin e punës së të gjithë institucioneve vendase për realizimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) dhe dokumentave të tjerë strategjike me Bashkimin Evropian.

Integrimi Evropian ka gjetur në çdo kohë mbështetjen e Parlamentit Shqiptar dhe të opinionit të gjërë publik (94% e shqiptarëve janë pro integrimit). E ç'ka është më e rëndësishmja, Shqipëria ka gjetur dhe mbështetjen e Bashkimit Evropian në këtë rrugë të gjatë e mjaft të vështirë, të cilën po e përshkojmë me sukses në një kohë kur Evropa po finalizon një transformim historik. Kur ajo po synon të ndahet njëherë e përgjithmonë prej shumë gabimeve të shekullit të kaluar e të krijojë kështu një imazh të ri, të një vendi që synon të jetë një partner i besueshëm në botë.

Procesi i Stabilizim Asocimit ka krijuar një filozofi të re, nxitëse e të orientuar drejt rezultateve praktike. Ky proces do ta ndihmojë Shqipërinë jo vetëm për të përballuar sfidat e integrimit evropian, por edhe për të ndërmarë më tej hapa të rëndësishëm në rrugën e konsolidimit të demokracisë. Raporti vjetor i Komisionit Evropian, Partneriteti Evropian dhe dokumentat lidhur me to përbëjnë një orientues të saktë për të matur rezultatet e ecurisë së reformave në vendin tonë.

Qeveria shqiptare e ka bërë të vetën këtë filozofi. Reformat për luftën kundër korrupsionit dhe kimit të organizuar, për krijimin e një ekonomie funksionale dhe të një sistemi të fortë ligjor të përmirësuar sipas "acquis communautaire" (e drejta europiane) dhe të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirisë së medias janë siguria për vijueshmërinë normale të procesit të ratifikimit të MSA-së.

Vlerësimi që Komisioni Evropian ka bërë për ecurinë e deritanishme të MSA-së, të Marrëveshjes së Ndërmjetme, për reformat rregullatore në fushën ekonomike dhe atë të prokurorimeve, është një fakt më shumë që na bën të besojmë se jemi vërtet në rrugën e duhur.

Muajt që vijnë do të jenë dëshmitarë të vendosmerisë tonë për të thelluar reformat dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian e vendet anëtare të Bashkimit Evropian për të realizuar dëshirën për të qenë të gjithë bashkë në atë vendndodhje, aty ku kemi endërruar prej vitesh të jemi: në Europë, si gjithë Europa.

Majlinda BREGU



MINISTER

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	4
2	Qëllimet	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	6
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008	7
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë.....	10
Aneks 1	Projekt-ligjet për t'u paraqitur	11
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	12
Aneks 3	Investimet publike.....	13
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj.....	14
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit.....	15

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Integritit ka për mision drejtimin dhe bashkërendimin e procesit të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Europian (BE), nëpërmjet përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, përfshirë përkthimin e tij, hartimit të politikave të integritit, programimin dhe monitorimin e zbatimit të ndihmës financiare nga Bashkimi Europian dhe informimit të publikut për këtë proces.

Ajo luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e institucioneve shqiptare dhe angazhimeve të ndërmarra prej tyre, në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit; në ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me atë të Bashkimit Europian, duke ndihmuar ministritë e linjës dhe institucionet e tjera qendrore për hartimin e legjislacionit të nevojshëm, për përmbushjen e detyrimeve, që rrjedhin nga marrëveshja e Stabilizim-Asociimit; në ndjekjen e nënshkrimit të marrëveshjeve të ndihmave financiare të Bashkimit Europian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të programeve TË BE-së (Programi CARDS, Programi i Fqinjësisë, TAIEX, IPA, si dhe programe të tjera ndihme, që mund t'i ofrohen Republikës së Shqipërisë).

Gjithashtu Ministria e Integritit përgatit edhe mekanizmat metodologjikë në funksion të lehtësimit të zbatimit të reformave sektorale, që rrjedhin nga negociimi dhe zbatimi i marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe njëkohësisht harton, së bashku me institucionet e tjera, Planin e zbatimit të MSA-së dhe kontrollon zbatimin e tij.

2 Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

Aplikimi për statusin e vendit kandidat për anëtarësim në BE, përgatitja për negociatat për anëtarësim;

- Përafrimi i legjislacionit dhe i standarteve të tjera me vendet e BE-së;
- Reformimi i plotë i strukturës dhe i kualifikimit të punonjësve, brenda vitit 2010 për t'ju përgjigjur më së miri sfidave të integritimit;
- Ngritja e një sistemi bashkëkohor të IT-së, përditësimi dhe publikimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së Ministrisë në ëëbsite-n e saj;
- Ngritja e një Sistemi të Komunikimit Online në funksion të procesit të monitorimit të zbatimit të MSA (përfshi aktet ligjore e nënligjore që transpozohen nga ministrive të linjës), të aksesueshëm/interaktiv nga të gjitha ministrivë të linjës;
- Orientimi dhe drejtimi i politikave shtetërore me qëllim zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga MSA brenda një periudhe 10 vjeçare të ndarë në dy faza 5 vjeçare;
- Koordinimi dhe monitorimi i reformave të kërkuara në përputhje me realizimin e detyrimeve të MSA për fazën e parë dhe të dytë të zbatimit të saj.
- Forcimi i kapaciteteve pranë MIE dhe njësitë e integritimit evropian pranë ministrive të linjës dhe institucioneve të përfshira për koordinimin e procesit të integritimit evropian;
- Rritja në publik e ndërgjegjësimit për të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga procesi i Stabilizim-Asocimit me theks ato që rrjedhin nga MSA;
- Vendosja/koordinimi i hapave metodologjike për procesin e përkthimit të *acquis communautaire* në gjuhë shqipe.
- Programimi në përputhje me prioritetet e procesit të SA dhe zbatimi me efektivitet i asistencës komunitare për Shqipërinë; sigurimi i bashkëpunimit me vendet fqinje për programet rajonale.
- Rritja e aftësive thithëse të asistencës komunitare nga ana e institucioneve përfituese shqiptare.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në menaxhimin e procesit të integritit, kualifikimin dhe menaxhimin bashkëkohor të burimeve njerëzore, përmirësimin e menaxhimit financiar, përmirësimin e infrastrukturës së mjediseve të punës dhe shërbimeve ndihmëse në funksion të realizimit të misionit të Ministrisë së Integritit.

3.2 DREJTËSIA DHE TREGU I BRENDSHËM

Politika e këtij programi konsiston në koordinimin, monitorimin dhe nxitjen e institucioneve Shqiptare për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA), me synim përgatitjen e vendit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian.

3.3 MBËSHTETJA INSTITUCIONALE PËR PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Politika e këtij programi konsiston në mbështetjen institucionale dhe financiare të procesit të Integritit Europian të Shqipërisë në nivel qendror e vendor për të siguruar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i Stabilizimit dhe Asociimit dhe progresin drejt anëtarësimit në Bashkimin Europian.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës:

- Drejtimi dhe koordinimi i veprimtarisë së Ministrisë nga autoritetet kryesore drejtuese për hartimin dhe zbatimin e politikës së Qeverisë në fushën e integritetit Europian dhe zbatimin e MSA-së.
- Drejtimi dhe koordinimi i punës së sektoreve të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme, parandalimi, kontrolli dhe zgjidhja e gjendjeve të konfliktit të interesit.
- Trainimi i stafit, brenda e jashtë vendit gjatë vitit 2008; ndërtimi i një baze të dhënash për punonjësit, rekrutimi sipas ligjit, si dhe mbështetja logjistike për stafin e Ministrisë.

Produktet kryesore që do të ofrohen:

- Mirëmenaxhimi i burimeve njerëzore, ekonomiko-financiare dhe plotësimi i nevojave logjistike të Ministrisë;
- Plotësimi i një baze të dhënash për punonjësit dhe trainimi i një numri prej 50 % të tyre,
- Përditësimi i faqes së internetit, mirëmbajtja e sistemit të teknologjisë së informacionit, energjisë elektrike dhe telefonisë fikse.

4.2 DREJTËSIA DHE TREGU I BRENDSHËM

Objektivat e politikës

- Mbështetje gjatë gjithë vitit për funksionimin dhe monitorimin e rezultateve të 12 njësisë të integritetit.
- Institucionalizimi i 20 grupeve ndërministrorë të punës në përputhje me fushat e zbatimit të MSA-së.
- Adresimi i prioritetëve të reja të dala nga dokumentat themelore të BE-së (Paketa e Zgjerimit) gjatë muajit Nëntor.
- Përafrimi i legjislacionit vendas me atë të BE-së, për fushat prioritare të fazës së parë 5 vjeçare (Neni 70)
- Mbështetje për trajnimin e rreth 900 nëpunësve civilë për çështjet e integritetit evropian.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Raporte të monitorimit të zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga MSA/MN;
- Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, i rishikuar mbi bazë vjetore;
- Akte ligjore/nënligjore shqiptare të çertifikuara për përputhshmërinë e tyre me aktet komunitare;
- Nëpunës civilë të trajnuar nga asistenca teknike e TAIEX.

- Nëpunës civilë të trajnuar nga projektet e Bashkimit Europian.

4.3 MBËSHTETJA INSTITUCIONALE PËR PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Objektivat e politikës

- Përmirësimi i cilësisë së projekteve të financuara nga asistenca e BE-së duke siguruar një lidhje më të mirë me prioritetet e procesit të SA.
- Intensifikimi i fushatave informuese dhe instutucionalizimi i bashkëpunimit me grupet e interesit rreth procesit të integrimit.
- Përkthimi i legjislacionit europian.

Produktet kryesore që do të ofrohen

- Manuale raportimi;
- Kapacitete administrative të trajnuara për raportimin në procesin e integrimit;
- 2500 faqe akte ligjore të përkthyer;
- Marrëveshja vjetore Financiare të IPAs;
- Fisha sektoriale të përgatitura në kuadër të programit IPA;
- Projekte të Programit CARDS të përfunduara me sukses dhe në kohë;
- Projekte në kuadër të bashkëpunimit rajonal të realizuara me sukses;
- Sesione informuese/trajnuese të organizuara
- Aktivitete të organizuara për ndërgjegjësimin e publikut;.
- Grupe interesi të institucionalizuara;
- Qendra komunikimi funksionale;

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

Programet	Pagat dhe kontribute të sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subveçione t 603	Të tjera transferta korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	28	15	0	0	0	14	57
Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm	22	6	0	0	0	1	29
Mbështetja Institucionale për Procesin e Integrimin	18	52	0	0	0	1	71
Total	68	73	0	0	0	16	157

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
Planifikimi i detyrimeve që rrjedhin nga MSA nga ana e institucioneve shqiptare dhe monitorimi i tyre, përmes rishikimit të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA		
Raportet e monitorimit të zbatimit të Planit të mesipërm “të përkthyer” në vlerësim pozitiv të KE në Raport-progresin vjetor	Nr. raportesh	4 raporte 3-mujore, 1 raport vjetor
Akte ligjore të propozuara të certifikuara për përputhshmërinë e tyre me acquis	Nr. aktesh	2500 faqe
Planifikimi i asistencës financiare të KE për vitin 2008 sipas prioritetëve të PSA, nëpërmjet Marrëveshjes Financiare të finalizuar për IPA 2008, komponenti I		
Fillimi i procesit të programimit të IPA 2009, mbledhja e projekt-fishave për projektet prioritarë		
Programet e bashkëpunimit rajonal të zbatuara, lancimi/administrimi i thirrjeve për propozime	Nr. programesh	6 programe bashkëpunimi në zbatim
Ndërgjegjesimi dhe informimi i publikut për procesin e integritetit Europian të Shqipërisë përmes Qendrave të informacionit për çështjet e BE-së	Nr. qendrash	1 qendër e re
Burime njerëzore të mirëmenaxhuara, stafi i MIE dhe ministrive të linjës i trajnuar për aspekte të ndryshme të procesit të integritetit	Nr. punonjësish	900 nëpunës të MI dhe min. të linjës të trainuar
Faqe e internetit e përditësuar me informacionin për procesin e Integritetit europian të Shqipërisë		
Ditë informacioni të organizuara për mundësitë për të përfituar projekte nga fondet e bashkëpunimit rajonal	Nr. ditësh informuese	10 ditë informuese

Aneks 1 Projekt-ligjet për t'u paraqitur

- Projektvendim “Për protokollin e Zgjerimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe të Marrëveshjes së Ndërmjetme”.
- Projektvendim për rishikimin e Vendimit Nr.577, dt.05.09.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 463, datë 5.7.2006 të Këshillit të Ministrave “Rishikimi i Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA”.
- Projektvendim “Për miratimin e marrëveshjes financiare për IPA 2008”
- Projekt-vendim “Për miratimin në parim të marrëveshjeve financiare për bashkëpunimin ndërkufitar/rajonat 2007”
- Projekt-vendim “Për miratimin e projekteve të financuara nga programi IPA shumëpërfitues 2007”

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

- Rezultatet kryesore që lidhen me Integrimin Evropian kanë të bëjnë kryesisht me rolin që ka Ministria e Integritit në këtë proces: Koordinimi dhe monitorimi i detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritit evropian; kontrolli i përputhshmërisë së legjislacionit vendas me legjislacionin komunitar dhe forcimi i kapaciteteve administrative.
- Në mënyre të vazhdueshme është bërë monitorimi i zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA (PKZMSA) dhe përgatitja e progres-raporteve mujore, tremujore dhe raporteve vjetore, të cilat raportohen periodikisht pranë Komisionit Evropian dhe palëve të tjera të interesuara. Në këtë kuadër bëhet një vlerësim i zbatimeve të angazhimeve të marra në PKZMSA dhe në bazë të detyrimeve që dalin edhe nga dokumente strategjike integruese është bërë i mundur përditësimi vjetor i PKZMSA.
- Janë zhvilluar periodikisht takimet vjetore të Komitetit të Përbashkët BE-Shqipëri, që mbulojnë kryesisht fushat e tregut të brendshëm si dhe takimet e Grupit Konsultativ të Përbashkët BE/Shqipëri, të cilat kanë trajtuar progresin e bërë në ecurinë e reformave, kryesisht në reformat që lidhen me kriterin politik. Takimi si çdo vit do të zhvillohet edhe gjatë 2008.
- Lidhur me kontrollin e përputhshmërisë së legjislacionit vendas me legjislacionin komunitar Ministria e Integritit ka dhënë opinione të specializuara sipas fushave, për përputhshmërinë e *acquis* me projektligjet dhe projekt vendimet e Këshillit të Ministrave, si dhe harmonizimin e Strategjive të ndryshme kombëtare me legjislacionin dhe parimet kryesore të të drejtës evropiane. Certifikimi i procesit të hartimit të ligjeve dhe amendamenteve në linjë me *acquis communautaire* do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2008.
- Ministria e Integritit vazhdimisht ka qënë e angazhuar për informimin e të gjitha institucioneve mbi mbështetjen që TAEX ka ofruar, kryesisht për përafrimin e legjislacionit vendas me *acquis* dhe për këtë qëllim janë organizuar si trajnime të ndryshme ashtu dhe takime individuale nëpër ministritë e linjës lidhur me funksionimin e këtij programi të rëndësishëm për përafrimin e legjislacionit.
- Për sa i përket forcimit të kapaciteteve administrative për integrimin e vendit janë zhvilluar takime të vazhdueshme me Njësitë e Integritit pranë Ministrive të Linjës me qëllim forcimin e rolit të tyre koordinues në këto ministri dhe institucione. Janë zhvilluar trajnime për njësitë e integritit evropian në Ministritë e Linjës për mirëfunksionimin e tyre dhe monitorimi i rezultateve të njësive të integritit si dhe të kontributit të tyre.

Aneks 3 Investimet publike

Objekti	Financimi buxhetor në mijë leke	
Rikonstruksion i Godinës	7000	
Pajisje Elektrike dhe elektronike	4400	
Pajisje zyre	3000	
TVSH për grantet		
'Drejtësia dhe Tregu i Brendshëm"	800	
TVSH për grantet		
Mbështetja Instituc.Proc.Integrimit"	800	
Totali	16.000	

Aktualisht, zbatimi i planit është në proces.

- 1.Rikonstruksioni i godinës, është në përfundim, akoma nuk janë marrë në dorëzim punimet dhe nuk është kryer likujdimi i tyre.
- 2.Blerje pajisjesh elektrike dhe elektronike, nuk është zhvilluar ende tenderi, do të zhvillohet në 3 mujorin e dytë 2008.
- 3.Blerje pajisje zyre, është kryer blerja, por akoma nuk është kryer likujdimi i tyre.
- 4.Realizimi i TVSH-së për 1.600 mijë lekë, varet nga donacionet e huaja, që të realizohet.

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Aktualisht, Ministria e Integritimit mbështetet nga projekti i CARDS 2005 “Forcimi i Ministrisë së Integritimit European” në shumën 2 milion Euro. Projekti ka si qëllim forcimin e kapaciteteve për implementimin e MSA dhe veçanërisht përmirësimin e mekanizmave të koordinimit midis MI dhe ministrive të linjës për çështjet e planifikimit, implementimit dhe monitorimit të asistencës komunitare. Ministria e Integritimit gjithashtu është mbështetur me një fond prej 56,000 nga programi CARDS 2005 për pajisjen e zyrave të reja. Gjithashtu, gjatë vitit 2008, Ministria e Integritimit do të përfitojë asistencën teknike të GTZ-së nëpërmjet projektit “Mbështetje për procesin e zbatimit të legjislacionit në përputhje me legjislacionin e BE-së”. Ky projekt përfundon në Dhjetor 2009 dhe ka për qëllim hartimin e strategjive dhe instrumentave për informimin e kualifikimin e autoriteteve publike dhe gjykatave, përgjegjës për zbatimin e legjislacionit të ri shqiptar të përafuar me atë European.

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

1. Në fushën e prokurimit publik: (i) trajnime të specialisteve nga ITAP dhe nga Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme, për kuptimin dhe zbatimin e legjislacionit të prokurimit publik (ii) emërimi në Njesinë e Prokurimit të specialistëve të fushës dhe me eksperiencë (iii) në Komisionet e Vlerësimit të ofertave, caktimi përveç zëvendëstitullarit të institucionit, edhe i specialistëve më të aftë të fushës përkatëse (iv) përdorimi i tenderit të hapur si procedurë kryesore e prokurimit (v) procedura transparente, të publikuara ne internet dhe në buletin e prokurimit publik.

2. Në përdorimin e fondeve buxhetore : (i) buxheti i zbatuar sipas planit, pa tejkalime; (ii) respektimi i ligjeve për pagat dhe shpërblimet (iii) përdorimi me efikasitet i vlerave materiale e monetare.

3. Në rekrutimin e punonjësve : (i) zbatimi i legjislacionit për nëpunësit civil, rekrutime të kryera me testim ose kontratë të miratuar në çdo rast nga Departamenti i Administratës Publike; procedura transparente, të publikuara në çdo rast në internet; punësim i ofruar specialistëve që kanë shfaqur aftësitë më të mira.